



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:080764
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05848714

2021:080765

C.nr.778/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B.R, I.S., M.H., A.H. dhe A.R., të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Rafiz Shehu nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, shujtave ditore dhe pagës jubilarë, me datë 24.06.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Ndërpritet procedura në këtë çështje juridike kontestimore **për shkak të vdekjes së paditësit M.H.**

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre av. Rafiz Shehu nga Ferizaj pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me 27.04.2021 kundër të paditurit, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, shujtave ditore dhe pagës jubilarë.

Gjykata sipas detyrës zyrtare iu është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile (ZGJC) - Ofiqarisë në Ferizaj me kërkesë për verifikim të faktit të vdekjes së paditësit, ku për të njëjtin me datë 21.06.2024 ZGJC në Ferizaj, e ka njoftur gjykatën përmes adresës elektronike se M.H. ka vdekur dhe si provë ia ka bashkangjitur certifikatën e vdekjes së tij të datës 21.06.2024, me

nr. rendor ..., nr. të referencës 19/...01, përmes së cilës vërtetohet se paditësi M.H. ka vdekur me datën 14.04.2022 në Prishtinë.

Andaj, bazuar në certifikatën e vdekjes dhe vetë faktit se tani paditësi M.H. është i vdekur, konform dispozitave ligjore nga neni 277 pika a) të LPK-së, ndryshuar dhe plotësuar me dispozitën e nenit 18 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPK, gjykata ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore në raport me këtë paditës. Ndërsa ka vendosur se procedura e ndërprerë do të vazhdojë kur trashëgimtarët e të ndjerit-paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare në kuptim të nenit 280.1 të LPK.

Nga arsyet e lartcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142.2 të LPK.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Datë 24.06.2024

**Gjyqtari,
Armend Ahmeti**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.